VENDIM
Nr. 435, datë 11.7.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 712, DATË 31.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT PUBLIK PËR TË DREJTËN E PESHKIMIT NË UJËRAT E BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 52, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

Në vendimin nr. 712, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

"5/1. Procedura e konkurrimit publik realizohet *online*, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*. Në konkurrim nuk do të pranohet asnjë dokumentacion shkresor përveç dokumentacionit të kërkuar në format elektronik gjatë procesit të aplikimit në portalin unik qeveritar *e-Albania*.".

2. Në pikën 10, fjalët "... paraqesin në ministri ..." zëvendësohen me "... depozitojnë nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania* ...".

3. Në pikën 14 bëhen këto ndryshime:

Shkronja "a" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Shkarkon dokumentacionin e depozituar në format elektronik gjatë procesit të aplikimit nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania* dhe ruan një kopje elektronike të tij;".

b) Shkronja "c" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c) Harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruhen pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit, si dhe renditja e subjekteve të kualifikuara sipas vlerësimit me pikë.".

4. Pas pikës 16 shtohet pika 16/1, me këtë përmbajtje:

"16/1. Për monitorimin e vazhdueshëm të kontratave ngarkohet struktura përgjegjëse për peshkimin në ministri. Procesi i monitorimit të kontratave përcaktohet me udhëzim të ministrit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi